



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 627, datë 27.10.2021

P Ë R

KALIMIN TE BASHKITË KURBIN E LEZHË TË OBJEKTEVE
ARSIMORE, SHKOLLA 9-VJEÇARE DHE KOPSHTI "DAN BAJRAMI",
BASHKIA KURBIN, SHKOLLA E MESME DHE PARASHKOLLORI
"LLESH NIK DAKA", BASHKIA LEZHË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin te bashkitë Kurbin e Lezhë, përkatësisht, të objekteve arsimore, shkolla 9-vjeçare dhe kopshti "Dan Bajrami", Bashkia Kurbin, shkolla e mesme dhe parashkollori "Llesh Nik Daka", Bashkia Lezhë, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Kurbin e Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE

ARBEN AHMETAJ

Te dhënat e përmbledhura për Objektet Anëmore (Tabela nr.1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emertimi	Tipologjia e Ndërtimit	Financimi (Nëse është)	Sipërfaqja (m ²)	Vlera e Projektit të ndërtimit	Vlera e Projektit të ndërtimit	Vlera e Projektit të ndërtimit	Vlera e Projektit të ndërtimit	Vlera totale e objektit
21	Qarku Lezhe	Kuhin	Gjerman	9-jetëshe e mirëmbajtjes	Dan Buzam	Ndërtim	Budhet G.O.A	3,565.0	1,163,333.13	128,340,402.49	1,385,635.27	137,237.56	131,046,610.46
22	Qarku Lezhe	Lezhe	Shërbimi		Lezhe N.K. Duka	Ndërtim	Budhet G.O.A	3,791.0	1,331,099.20	140,000,000.00	1,608,664.73	159,346.89	152,141,008.32
TOTAL								7,056.0	2,494,432.3	277,600,000.00	2,994,500.00	296,584.3	281,888,516.8

NR.PROT. 5123/1
DATE 28.10 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKIVE KURBIN DHE LEZHË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

